



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-089

Prishtinë, më 14 janar 2013, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 14 JANAR 2013

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Petar Miletiq dhe Enis Kervan, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani dhe Mufera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Skender Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca;

Nga: OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe dy pika shtesë.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d d i t e

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 17 dhjetor 2012,
2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 17 dhjetor 2012

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 17 dhjetor 2012.

* * *

Kryetari i Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, Visar Ymeri, propozoi që Kuvendi të diskutojë dhe të marrë qëndrim lidhur me bisedimet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, para se të mbahet takimi ndërmjet kryeministrit të Kosovës dhe atij të Serbisë, në Bruksel, më 17 janar 2013.

Kryesia konstatoi se Kuvendi mund të debatojë për çështjen e shtruar nga kryetari i Grupit Parlamentar “Vetëvendosje” pasi të plotësohen kushtet e parapara me Rregulloren e Punës së Kuvendit.

2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare, vendosi që mbledhja plenare e Kuvendit të mbahet të hënën, më 21 janar 2013, me këtë:

R e n d d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për transplantimin e organeve,
5. Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Universitetit të Prishtinës,
6. Shqyrtimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër korrupsionit për periudhën 2013-2017,

7. Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media,
8. Zgjedhja e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe kërkesave

1. Procedimi i programit legjislativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2013

Kryesia, pasi diskutoi për programin legjislativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin

2013, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Programi legjislativ i Qeverisë së Kosovës për vitin 2013 t'u shpërndahet të gjithë deputetëve të Kuvendit.

2. Ngarkohen komisionet parlamentare që në bazë të programit legjislativ të Qeverisë së Kosovës për vitin 2013 dhe të propozimeve të tyre, t'i hartojnë planet e punës periodike dhe programin e punës së komisioneve për vitin 2013 deri më 28 janar.

3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme për Çështje Ligjore dhe Procedurale që në bazë të planeve të punës së komisioneve parlamentare, ta hartojë propozim-programin e punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2013, i cili me propozim të Kryesisë së Kuvendit duhet t' i procedohet mbledhjes plenare për miratim.

2. Procedimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-101 për fondet pensionale të Kosovës

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me projektligjin e cekur më lart, e nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-101 për fondet pensionale të Kosovës, të hartuar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, t'u shpërndahet të gjithë deputetëve të Kuvendit.

2. Ngarkohet Komisioni për Buxhet dhe Financa, si Komision Funkcional, që ta përgatisë raportin preliminar për shqyrtimin e parë të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-101 për fondet pensionale të Kosovës.

3. Kërkesa e deputetit Ramë Vataj, e mbështetur nga deputetët nënshkrues, për debat parlamentar në lidhje me procesin e zgjedhjes së kandidatëve për anëtarë të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, konstatoi që duhet të bisedohet me deputetin Ramë Vataj lidhur me procedimin e kësaj kërkesë.

4. Propozimi i panelit vlerësues të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për plotësimin e një pozite për anëtar joekzekutiv të Bordit të BQK-së

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me propozimin e lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Buxhet dhe Financa, si Komision FunkSIONAL, që ta shqyrtojë propozimin e panelit vlerësues të Bankës Qendrore të Kosovës për plotësimin e një pozite për anëtar joekzekutiv të Bordit të BQK-së dhe Kuvendit t’ia paraqesë raportin me rekomandime.

5. Kërkesa e Komisionit për Punë të Jashtme për lejimin e organizimit të konferencës “Bashkëpunimi rajonal, integrimi evropian dhe roli i diplomacisë parlamentare”

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet organizimi i tryezës së rrumbullakët në ndërtesën e Kuvendit të Kosovës, me përfaqësues të komisioneve për punë të jashtme nga parlamentet e rajonit, si: Bosnjë-Hercegovina, Bullgaria, Greqia, Hungaria, Kroacia, Maqedonia, Mali i Zi, Rumania, Shqipëria, Sllovenia, Turqia dhe deputetët e Parlamentit Evropian: znj. Doris Pak, z. Eduard Kukan, znj. Ulrike Lunaček dhe znj. Tanja Fajon, që do mbahet më 11 mars 2013, me temën: “Bashkëpunimi rajonal, integrimi evropian dhe roli i diplomacisë parlamentare”.

2. Shpenzimet e akomodimit dhe të drekave zyrtare për pjesëmarrësit e ftuar në këtë tryezë, prej 10-12 mars 2013, mbulohen nga buxheti i Kuvendit.

6. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në SHBA

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i deputetëve të Kuvendit, në këtë përbërje: Adem Grabovci, Flora Brovina, Lutfi Haziri dhe Ardian Gjini, për të marrë pjesë në Lutjet e 61-ta të Mëngjesit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, prej 4 deri më 9 shkurt 2013.

2. Të gjitha shpenzimet e këtij udhëtimi për të lartshënuarit në paragrafin një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit.

7. Njoftimi i Nënkomisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Kuvendit lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Kroaci, prej 12 - 14 nëntor 2012

Kryesia u njoftua me vizitën e Nënkomisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Kuvendit, të realizuar Kroaci, prej 12-14 nëntor 2012.

Pikat shtesë:

1. Zgjedhja e katër anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me çështjen e cekur më lart, këtë pikë e radhiti në rend dite për mbledhjen plenare më 21 janar 2013.

2. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Strasburg

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i deputetëve të Kuvendit në këtë përbërje: Hydajet Hyseni dhe Vjosa Osmani, si dhe i zyrtarit të protokollit Snoudon Daci për të marrë pjesë në Këshillin e Evropës, në Strasburg, prej 21 - 23 janar 2013.

2. Të gjitha shpenzimet e këtij udhëtimi për të lartshënuarit në paragrafin një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 12:10 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale